



KUVENDI I SHQIPTARËVE TË ZVICRES
RAT DER ALBANER DER SCHWEIZ
ASSEMBLÉE DES ALBANAIS DE SUISSE
ASSEMBLEA DEGLI ALBANESI DI SVIZZERA

Lausanne, me 5 mars 2016/JK

Ftesë për Konferencën e dytë të Diasporës shqiptare të Zvicrës

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,

Kuvendi i Shqiptarëve të Zvicrës (KShZ), fton për pjesëmarrje në Konferencën e dytë të Diasporës shqiptare të Zvicrës. Pasi që pjesëmarrësit e konferencës së parë të organizuar më 13 shtator 2015 kërkuan të organizohet konferenca e radhës si rrjedhojë KSHZ, organizon Konferencën e dytë të përbashkët me shoqatat dhe institutet shqiptare në Zvicër.

Ashtu si në Konferencën e parë, qëllimi kryesor i kësaj konference është që akterët e aktiviteteve shqiptare në Zvicër të njoftohen me njëri tjetrin, të kenë mundësi dhe një vend për të shkëmbyer mendimet, për të debatuar. Kështu që të krijohet një platformë, brenda së cilës të koordinohen çështjet me interes të përgjithshëm të komunitetit shqiptarë në Zvicër.

Duke marrë parasysh numrin e konsiderueshëm të shqiptarëve dhe të shoqatave shqiptare, si ato kulturore, profesionale, sportive, fetare dhe humanitare në Zvicër, të cilat funksionojnë dhe japin kontribut të çmuar në zhvillimin e komunitetit shqiptarë në Zvicër, është e drejtë që të organizohen, në mënyrë që të marrin pjesë edhe më shumë dhe në mënyrë të organizuar në debate shqiptaro-zvicerane dhe me vendlindje. Mënyra e duhur për të arritur këtë qëllim, është pa dyshim ngritja e një platforme të përbashkët brenda së cilës do të kanalizohen sinergjitë dhe potenciali për realizimin e interesave të përbashkëta.

Në këtë Konferencë është i ftuar një përfaqësues i Republikës së Kosovës në Zvicër, i cili do ti përshëndesë të pranishmit.

- Forma e organizimit të Konferencës

Çdo shoqatë përfaqësohet nga disa persona. Struktura e debatit do jetë e hapur dhe çdo përfaqësues do ketë mundësi të shpalosë platformën, idetë dhe sugjerimet e shoqatës që e përfaqëson në interes të platformës së përbashkët.

Në fund të Konferencës do nxirren konkluzione për format e bashkëpunimit në të ardhmen.

Për arsye organizative, ju lutemi ta konfirmoni pjesëmarrjen (me numrin e pjesëmarrësve) përkatësisht mospjesëmarrjen tuaj, deri me datën 10.03.2016 në këtë email: avni.binaku@gmail.com apo në Mobil. 078/804.44.06. Programin e konferencës ua dërgojmë pas konfirmimit të pjesëmarrjes.

KShZ është themeluar në qershor të vitit 2011 në Bernë me qëllim të bashkimit e potencialit kulturor, shkencor, ekonomik dhe politik të Shqiptarëve të Zvicrës në shërbim të komunitetit shqiptarë, ndaj të vendeve të prejardhjes dhe të Zvicrës.

Konto postale : 85-343784-8 CHF
IBAN : CH71 0900 0000 8534 3784 8

E-mail : info@kuvendishqiptar.com
Webfaqe : www.kuvendi.ch